



KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr.40, datë 05.04.2017

PËR

“MIRATIMIN DHE ZBATIMIN E PROJEKTIT “TË RINJTË DHE TË REJAT DREJT NJË PROFESIONI”, HARTUAR SIPAS UDHËZUESIT OPERACIONAL PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT “TË RINJTË DHE TË REJAT DREJT NJË PROFESIONI”

Në mbështetje të nenit 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1 shkronja “b”, nenit 24, nenit 54 shkronja “k”, nenit 55 pikat 2 dhe 6 të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen vendore”; Ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 për “Ndihmën shtetërore” (i ndryshuar), Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.58, datë 30.12.2015 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2016- 2018 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2016”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr.84, datë 29.12.2016, për “Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2017 – 2019 dhe detajimin e Buxhetit të Bashkisë Tiranë për vitin 2017” me propozim të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës, Këshilli Bashkiak;

V E N D O S I:

1. “Miratimin dhe zbatimin e projektit “Të rinjtë dhe të rejtat drejt një profesioni”, hartuar sipas Udhëzuesit Operacional për Zbatimin e Projektit “Të rinjtë dhe të rejtat drejt një profesioni” bashkëlidhur këtij vendimi si shtojca 1.
2. Efektet financiare të pikës 1 të këtij vendimi në shumën 2.100.000 lekë (dy milion e njëqindmijë lekë), do të përballohen nga fondi për projektet sociale, Aparati i Bashkisë në programin e Kujdesit Social parashikuar në Buxhetin e Bashkisë Tiranë për vitin 2017
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit Nr.139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Tiranë.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI



Udhëzues Operacional

**për zbatimin e Projektit
“Të rinjtë dhe të rejtat drejt një profesioni”**

Miratimi

Ky Udhëzues u hartua nga Bashkia e Tiranës, (Drejtoria e Nxitjes së Punësimit) duke u bazuar në praktikat më të mira nga rajoni i Ballkanit.

Shkurtime dhe akronime

Komisioni	Komisioni i Vlerësimit
Koordinatori	Koordinatori i Projekti
Bashkia	Bashkia e Tiranës
UO	Udhëzues Operacional
Projekti	Projekti “Të rinjtë dhe të rejat drejt një profesioni”

1. Hyrje

Integrimi i të rinjve në Tregun e Punës në përfundim të studimeve has vështirësi të shumta, një prej të cilave është edhe të qenurit pa eksperiencë punë. Sipërmarrja gjithashtu ka provuar se është në vetvete një katalizator për rritjen ekonomike, por edhe kjo është e vështirë për të rinjtë e sapodiplomuar të cilëve ju mungon eksperiencia, e po ashtu edhe mjetet financiare.

Fuqizimi ekonomik i të rinjve, nëpërmjet rritjes së aksesit në tregjet e punës edhe nëpërmjet përmirësimit të mundësive për sipërmarrjen e tyre është një politikë që gradualisht po fiton vëmendje në politikën e Bashkisë Tiranë, si një mjet për të garantuar konsolidimin e të drejtave të të rinjve.

Për t`a vazhduar më tej këtë shtysë dhe për të bërë të mundur suksesin e financimit të veçantë të vitit 2017-të për të rinjtë, Bashkia e Tiranës prezanton Zbatimin e Projektit “Të rinjtë dhe të rejtat drejt një profesioni”.

Projekti synon të krijoj lehtësi për punësimin e të rinjve të sapodiplomuar në kërkim të një pune. Projekti kontribuon në punësimin e të rinjve të papunë, duke pasur në vëmendje grupe të vecanta, të cilëve jo vetëm u përmirëson standartin e jetesës por edhe iu jep atyre mundësinë për t`u integruar në tregun e punës. Pra, ky projekt synon sigurimin e punësimit për të rinjtë e sapodiplomuar, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në uljen e papunësisë. Nëpërmjet këtij Programi mbështetet krijimi i vendeve të reja të punës, duke bashkëpunuar me punëdhënësin.

Projekti do të përfshij të rinjtë deri në moshën deri 29 vjeç, të cilët kanë përfunduar studimet universitare brenda apo jashtë vendit, kanë më pak se 36 muaj që kanë mbaruar këto studime dhe janë të papunë.

Prioritet do t`ju jepet të rinjve të cilët janë nga kategori të vecanta. Aplikanti duhet të ofroj besueshmëri, përkushtim dhe gadishmëri pranë biznesit ku do të kryej praktikën i cili do të kryej edhe vlerësimin përfundimtar të tij dhe në rastin më të mirë për të arritur në synim punësimin pas përfundimit të programit.

Gjatë zhvillimit të praktikës ata do të marrin një pagë në nivelin minimal sipas kuadrit ligjor të përcaktuar deri në përfundimin e praktikës profesionale.

Këta Udhëzues Operacionalë (UO) ofrojnë orientime hap pas hapi për procesin e zbatimit të Projektit. Dokumenti përmban seksionet e mëposhtme: Seksioni një ofron një prezantim të përgjithshëm të Projektit; Seksioni dy përkufizon elementët kyç të Projektit. Seksioni tre përfshin Informacion për Menaxhimin e Fondit dhe Organet e Zbatimit dhe Seksioni katër përshkruan procedurat hap pas hapi për zbatimin e projektit.

2. Elementët kyç

2.1. Informacion i përgjithshëm

Fondi në ndihmë të zhvillimit të programit “Për Projektin Të rinjtë dhe të rejtat drejt një Profesioni” i financuar nga burime publike (të parashikuara në zërin e buxhetit Kujdesi Social dhe Solidariteti), Të rinjtë

dhe të rejtat drejt një profesioni dhe i projektuar për të mbështetur të rinjtë, të aftë për të pasur sukses në një treg konkurrues. Shuma totale e financimit për vitin 2017-të arrin deri në **2.100.000 LEKË**. Projekti do të zbatohet nëpërmjet një procesi të bazuar në konkurrencë, me qëllim kthimin më të lartë të mundshëm të investimit. Procesi i përzgjedhjes së aplikantëve synon të sigurojë transparencë dhe konkurrencë të ndershme, dhe të mbështesë të rinjtë me rezultatet më të mira, diplomuar brenda apo jashtë vendit në universitetet publike apo private.

Procesi do të kryhet në tre faza.

Së pari, kandidatët e pranueshëm aplikojnë me plotësimin e formularit për t'u pranuar që të marrin pjesë në projekt.

Së dyti, aplikantët e përzgjedhur dërgohen pranë Biznesit për praktikën e punës sipas degës së studimit që kanë përfunduar.

Së treti, fituesit e shpallur nënshkruajnë një kontratë jo më shumë se 6 muaj me Biznesin dhe Bashkinë Tiranë, ku ata do të zhvillojnë Internshipin sipas Kodit të Punës.

2.2. Aplikantët e pranueshëm

Projekti është hartuar për kandidatët në kërkim të një pune që synojnë fillimin e një karriere profesionale sipas studimit të kryer. Kandidatët e përzgjedhur janë të detyruar të marrin pjesë personalisht në të gjitha aktivitetet e Projektit, pasi ata janë drejtpërdrejt të përfshirë në zhvillimin dhe zbatimin e planit të punës të përcaktuar nga vetë ata.

Kandidatët e kualifikuar dhe pjesëmarrësit e Projektit janë **Të rinjtë dhe të rejtat që janë rezidentë në territorin e Bashkisë së Tiranës**, në momentin e aplikimit.

Të rinjtë që nuk pranohen për të aplikuar janë ato që preken nga konflikti i interesit me palët e përfshira dhe vendimmarrësit e Projektit.

Projekti do të ketë kuota që kufizojnë numrin e aplikantëve, dhe shumën e financimit.

E drejta për të marrë pjesë në Projekt dhe për të pasur akses në marrjen e grantit mund të përdoret vetëm një herë në vit.

Të drejtën për të aplikuar e kanë:

- Të rinjtë dhe të rejtat deri në moshën 29 vjec, të cilët kanë mbaruar arsimin e lartë brenda apo jashtë vendit, kanë më pak se 36 muaj që kanë mbaruar këto studime dhe janë të papunë.

Do të trajtohen me prioritet të rinjtë dhe të rejtat :

- Të rinjtë dhe të rejtat banorë të Bashkisë së Tiranës, duke përfshirë edhe zonat rurale;
- Të rinjtë dhe të rejtat me aftësi të kufizuara;
- Të rinjtë dhe të rejtat që kanë përfunduar studimet me rezultate të larta;
- Të rinjtë dhe të rejtat të aftë për punë të familjeve që përfshihen në skemën e ndihmës ekonomike dhe grupeve të tjera të disavantazuara.
- Të rinjtë dhe të rejtat të papunë që nuk u përkasin kategorive më lartë por do të punësohen në projekte të cilat janë në ndihmë të Bashkisë Tiranë.

2.3. Shuma e grantit

Fondi total i Projektit për vitin 2017-të është 2.100.000 **milione LEKË**, nga ku do të shpallen **15 – 20 përfitues** dhe masa e financimit për individ do të jetë në nivelin e pagës minimale bruto për secilin përfitues që do të zhvillojë me sukses Praktikën profesionale.

Aplikanti duhet të ofrojw besueshmëri, përkushtim dhe gadishmëri pranë biznesit ku do të kryejw praktikën i cili do të kryejw edhe vlerësimin përfundimtar të tij.

Fondi do të përdoret vetëm për rimbursimin e punëdhënësit vetëm për pagat minimale Bruto të të punësuarve sipas këtij Programi. Kjo gjë do të zbatohet duke paraqitur në përputhje me parashikimet kontraktuale mes palëve sipas Aneksit 5.

2.4. Pranueshmëria e aktiviteteve të cilat do të marrin praktikantë.

Aktivitetet e pranueshme

Sektorët e Aktivitetit të pranueshme të biznesit në këtë projekt do të jenë nga sektorët e mëposhtëm:

- Sistemi Bankar;
- Turizmi;
- Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK);
- Industria;
- Shërbime;
- Shërbime Ligjore, Konsulente, Financiare.

Sektorët mund të ndryshojnë përgjatë secilit vit, në varësi të prioriteteve të përcaktuara nga Bashkia e Tiranës në varësi të studimit të tregut të punës që zhvillon Bashkia Tiranë.

Aplikantët e pranueshëm :

Prioritet do u jepet aplikantëve:

- Sipas rezultateve, te arritura gjatë viteve të studimit
- Te sapodiplomuarve që nuk kanë arritur të sigurojnë një vend pune në një periudhë më pak se 36 muaj.
- Grupeve të vecanta.
- Profileve të cilat tregu i punës ofron më shumë mundësi punësimi

Shpenzimet e pranueshme dhe jo të pranueshme

Shpenzimet e pranueshme që do të mbulohen nga ky grant duhet të përdoren për zbatimin e planit duke përfshirë:

- Pagën minimale bruto.

Shpenzimet jo të pranueshme që nuk mund të mbulohen nga paratë e grantit përfshijnë:

- çdo shpenzim që nuk lidhet me projektine propozuar;
- shpenzimet e kryera pas përmbylljes së kontratës së grantit.

Shpenzimet jo të pranueshme në grant mund të mbulohen nëpërmjet kontributit personal të aplikantit, ose vetë biznesit.

2.5. Mbulimi gjeografik

Në vitin 2017, Projekti do të zbatohet në territorin e Bashkisë së Tiranës përfshi të 24-ta Njësitë Administrative.

3. Organet e projektit

Projekti i Fondit “Të Rinjtë dhe të Rejat drejt një Profesionit” do zbatohet nga Bashkia e Tiranës, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, nëpërmjet Drejtorisë së Nxitjes së Punësimi.

Drejtori të tjera që do të përfshihen në disa hapa konkretë të zbatimit, janë si në vijim:

- Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Liçensimit
- Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit Ekonomik
- Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar
- Drejtoria e Përgjithshme e Promovimit të Qytetit

Projekti po zbatohet nga organet e mëposhtme:

- Komisioni i Vlerësimit
- Koordinator i Projektit/Sekretari i Komisionit
- Mentorë

Organigrama e Projektit paraqitet më poshtë:



3.1. Organet e menaxhimit

Komisioni për Vlerësimin

Komisioni për Vlerësimin do të përbëhet nga 3 anëtarë: 2 përfaqësues të Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit, dhe 1 përfaqësues i Drejtorisë së Rinisë. Takimet e Komisionit do të organizohen në zyrën e Bashkisë së Tiranës. Paneli do të kryesohet nga një përfaqësues më i lartë në hierarki të Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit. Emrat e anëtarëve të Komisionit nuk do të bëhen publikë para përzgjedhjes së aplikantëve.

Anëtarët e Komisionit do të mbledhen fillimisht për të vlerësuar aplikimet e studentëve në mënyrë të pavarur, bazuar në kriteret e përcaktuara.

Së dyti, Komisioni do të bëjë një verifikim administrativ Formularit të aplikimit të paraqitur sipas kriterëve të përcaktuara.

Së treti, Komisioni do të shqyrtojë opinionet dhe pikët e dhëna nga cdo anëtar.

Së fundi, Komisioni rendit aplikantët sipas pikëve përfundimtare për secilin aplikant

Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të bien dakord me rezultatet përfundimtare dhe listën e pranuar të aplikantëve fitues për financim.

Koordinatori i Projektit vepron si Sekretar gjatë takimeve dhe harton procesverbalin e takimeve.

3.2. Organet operationale dhe të mbështetjes

Koordinatori i Projektit

Një përfaqësues i Drejtorisë së Nxitjes së Punësimit në Bashkinë e Tiranës shërben si Koordinator Projekti dhe është përgjegjës i menaxhimit operacional të Projektit. Koordinatori është përgjegjës për zbatimin në kohë të të gjitha aktiviteteve të Projektit dhe ndjek kalendarin e miratuar duke përgatitur dhe dokumentuar në një dosje të vecantë cdo dokument zyrtar. Gjithashtu, organizon takimet e Komisionit të Vlerësimit, siguron shpërndarjen e dokumenteve tek ata.

Koordinatori është përgjegjës për menaxhimin e të gjitha dokumenteve të Projektit dhe ruajtjen në Drejtorinë e Nxitjes së Punësimit, dhe i mban ato në arkiv për të paktën 3 vite pas përfundimit të Projektit.

Mentorët e Projektit

Për ndjekjen e projektit gjatë fazës së zbatimit si dhe të paktën një periudhë jo më shumë se 6 muaj në përfundim të projektit ata do të monitorojnë procesin e zbatimit dhe mbarëvajtjen e projektit. Mentorët do të caktohen nga Drejtoria e Nxitjes së Punësimit.

4. Udhëzuesi për zbatimin

Projekti “Të rinjtë dhe të rejtat drejt një Profesionit”, do të zbatohet në një cikël që ndjek hapat e mëposhtëm:

1. Fushata informuese dhe mbledhja e aplikimeve (*Formulari i Aplikimit per Intership*)
2. Përzgjedhja e aplikantëve;
3. Kontraktimi dhe zbatimi i projektit;
4. Monitorimi dhe vlerësimi.

Për vitet e ardhshëm, Bashkia mund të vendosë të ketë dy cikle për vit me një fond më të gjerë.

4.1. Fushata informuese dhe mbledhja e aplikimeve.

Fushata informuese

Një fushatë informuese tre-javore do të organizohet duke pasur si objektiv aplikantët e pranueshëm, të gjitha Universitetet, (publike-private) OJF-të, institucionet, partnerët që mund të informojnë të rinjtë, që jetojnë në zonat urbane dhe rurale të Bashkisë.

Një *Njoftim Publik* (Aneksi 1) do të hartohet nga Koordinatori i Projektit. Njoftimi duhet të përfshijë informacion për tërësinë e procesit të aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë. Ai duhet të përfshijë gjithashtu informacion për çdo takim informues që do të organizohet gjatë tre javëve. Njoftimi do të publikohet nga Bashkia në faqen zyrtare si edhe në të gjitha rrjetet sociale të Bashkisë edhe Kryetarit të saj. Gjithashtu, njoftimi do të publikohet edhe në faqet e partnerëve dhe mbështetësve të rinise, në bordet e buletinit në Bashki dhe ato të institucioneve të tjera vendore (OJF dhe zona të tjera ku ka një lëvizje të madhe). Formulari i Aplikimit për Internshipin duhet të hidhet online, si edhe të jetë në dispozicion në kopje të printuara në të gjitha zyrat bashkiake përkatëse.

Takimet informuese do të organizohen në vende të ndryshme në territorin e Bashkisë për të transmetuar informacionin e nevojshëm të të gjithë aplikantët në një mënyrë të standardizuar. Synimi i këtyre takimeve do të jetë shpërndarja e informacionit të aplikantët e mundshëm të pranueshëm, që në të kundërt do të kenë akses të kufizuar të kanalet formale të komunikimit. Takimet do të publikohen në gazeta, faqe interneti, media dhe mjete të tjera të përkatëse të komunikimit.

Takimet informuese do të organizohen gjatë dy javëve të para të fushatës. Duke përdorur një qasje hap pas hapi, aplikantët informohen për kushtet e përgjithshme të Projektit, procedurat e aplikimit dhe kriteret e pranueshmërisë. Së fundi, *Formulari i Aplikimit për Internship* (Aneksi 3) do të jetë në dispozicion gjatë këtyre takimeve.

Për më tepër, Projekti do të promovojë kanalet e tjera të medias, siç janë konferencat për shtyp, artikujt e gazetave, revistat dhe gazetatat, portalet e punësimit, kryeartikujt të veçantë online nëpërmjet medias sociale dhe nga kanale dhe aktivitete të tjera të marrëdhënieve me publikun të përdorura nga Bashkia.

Dorëzimi/Mbledhja e Formularëve të Aplikimit për Internship

Të gjitha publikimet, takimet informuese, njoftimet dhe materialet e tjera do të ofrojnë informacion për aplikantët e interesuar mbi afatet e dorëzimit dhe procesin e përzgjedhjes. Të gjithë *Formularët e Aplikimit për Internship* të plotësuar duhet të dorëzohen pranë Sektorit të Pritjes me Qytetarin, në Bashki. Aplikantët duhet të dorëzojnë Formularin në origjinal dhe në dy kopje të tjera identike. Aplikantët janë të detyruar të paraqesin dokumentacione shtesë, në dokumentet e *Formularit të Aplikimit për Internship*, që provojnë arsimin, kualifikimin.

Afati përfundimtar për dorëzimin e *Formularëve të Aplikimit për Internship* është në fund të fushatës informuese tre-javore. Ky afat shpallet qartësisht në të gjitha thirrjet publike për secilin cikël të Projektit dhe *Formularin e Aplikimit për Internship*.

Formulari i Aplikimit për Internship i plotësuar (një origjinal dhe dy kopje) dhe dokumentet bashkëngjitur duhet të dorëzohen personalisht tek Zyra e pritjes me Qytetarin në Bashki, me orët e punës, në një zarf të vulosur që drejtohet si më poshtë.

<p>BASHKIA E TIRANËS</p> <p>DOKUMENTE PËR PJESËMARRJE NË PROJEKTIN E FONDIT “TË RINJTË DHE TË REJAT DREJT NJË PROFESIONI”</p> <p>FORMULARI I APLIKIMIT PËR INTERSHIP</p> <p>APLIKANTI:</p> <p>Emri, Mbiemri</p> <p>Rruga dhe numri, Kodi Zip dhe Qyteti</p>

Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm. Për aplikimet e marra me postë, e vlefshme është data e dërgimit (vula e postës). Aplikime të tilla pranohen edhe nëse merren pas afatit përfundimtar.

Aplikimet pranohen sipas procedurave të mëposhtme:

- Një verifikim formal i adresës, sipas shembullit të mësipër kryhet në Sektorin e Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët, dokumentet të cila nuk kanë adresë, ose që kanë adresë të gabuar, nuk do të pranohen;
- Çdo kandidati i caktohet një numër reference me vulën e Bashkisë;
- Çdo ditë, deri në afatin përfundimtar të dorëzimit të dokumenteve, Koordinatorin e Projektit merr nga Sektori i Informimit dhe Shërbimeve për Qytetarët të gjitha aplikimet e marra (zarfa) dhe i ruan në zyrën e tij/saj pa i hapur ato, me qëllim ruajtjen dhe transparencën e gjithë procesit.

4.2. Përzgjedhja e aplikantëve

Shqyrtimi dhe vlerësimi i *Formularëve të Aplikimit për Internshipin* do të kryhet nga Komisioni i Vlerësimit. Takimi do të organizohet nga Koordinatorin e Projektit.

Procesi për vlerësim administrativ dhe përzgjedhjen e kandidatëve duhet të fillojë jo më gjatë sesa dy ditë pune pas afatit përfundimtar për dorëzimin e Formularit. Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të jenë të pranishëm në takim. Procesi nuk duhet të zgjasë më shumë se tre ditë pune.

Koordinatori i Projektit shpërndan të gjithë zarfat e marrë me aplikime. Anëtarët e Komisionit dhe Koordinatori kontrollojnë së pari emrat e aplikantëve. **Në rastin e dublikimeve të aplikimeve (më shumë se një aplikim për person) të gjitha aplikimet nga i njëjti aplikant përjashtohen nga Projekti.** Secili grup ndahet në 6 shtylla, sipas sektorëve të pranueshëm të biznesit.

Më pas, anëtarët e Komisionit dhe Koordinatori hapin të gjithë zarfat e mbetur. Aplikimet vlerësohen nga sektorët.

Secili anëtar i Komisionit do të vlerësojë secilin aplikim individualisht sipas matricës së mëposhtme:

- *Formulari i Vlerësimit të Aplikimit (Aneksi 4)* përbëhet nga pesë seksione:
 - ✓ **Seksioni i parë**, një total prej 15 pikësh mund t'i jepet aplikantit bazuar në prioritetet e përgjithshme të vendosura nga Projekti, sipas dokumentacionit të paraqitur
 - ✓ **Seksioni i dytë** i pyetjeve mund të kontribuojë me një maksimum prej 15 pikësh dhe i referohet realizueshmërisë së intershipit sipas sektoreve të aktivitetit.
 - ✓ **Seksioni i tretë** mund të kontribuojë me një total prej 15 pikësh dhe mbulon aftësitë, zotësitë dhe përvojën personale të aplikantëve për të ushtruar Internshipin
 - ✓ **Seksioni i katërt** i pyetjeve mund të kontribuojë me një maksimum prej 15 pikësh dhe i referohet arsyes së përzgjedhjes së Praktikantit.
 - ✓ **Seksioni i pestë**, një total prej 15 pikësh do t'i jepet nëse do të jetë prej grupeve prioritare, nëse ata i përkasin një grupi të vecantë.

Nëse gjatë procesit të vlerësimit konsiderohet se dokumentet e aplikantit janë të rreme, këta aplikantë do të përjashtohen menjëherë. Gjatë takimeve, Komisioni do të paraqesë arsyet e kualifikimit të aplikantëve si edhe për refuzimin e tyre.

Pikët përfundimtare për secilin aplikant janë pikët mesatare të tre anëtarëve të Komisionit. Komisioni rendit aplikantët për secilin grup veçmas sipas pikëve përfundimtare të secilit vlerësues dhe më pas nga të tre vlerësimet nxjerrin mesataren.

Kryetari i Komisionit ka të drejtën e drejtimit dhe mbarëvajtjes së mbledhjes së Komisionit.

Pas finalizimit të procesit të përzgjedhjes, Sekretari i Komisionit (Koordinatori i Projektit) do të përgatisë listën përfundimtare të aplikantëve për miratim brenda tre ditë pune. Me miratimin, lista përfundimtare do të bëhet publike (në stendën e buletinëve, faqen e internetit të Bashkisë, dhe vende të tjera publike).

Koordinatori i Projektit do të kontaktojë me email ose telefon aplikantët që kanë kaluar fazën e parë të përzgjedhjes, dhe do t'u kërkojë të konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në fazën e dytë të procesit të përzgjedhjes brenda 3 ditësh pune. Nëse disa nga aplikantët e pranuar nuk konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në program, vendet e tyre do të zihen nga aplikantët ndjekës në renditje sipas renditjes së pikëve.

Çdo aplikim i marrë pas datës përmbyllëse të shpallur do të konsiderohet i pavlefshëm. Për aplikimet e marra me postë, e vlefshme është data e dërgimit (vula e postës). Aplikime të tilla pranohen edhe nëse merren pas afatit përfundimtar.

4.3 Përzgjedhja e Subjekteve në të cilat do të realizohet praktika.

Në program për zhvillimin e praktikës do të përzgjidhen :

- Ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë së Tiranës.
- Ndërmarrjet që nuk kanë detyrime financiare ndaj pushtetit qendror dhe vendor.
- Zbatojnë Kodin e Punës në lidhjen e kontratave të punës me punëmarrësit.
- Janë të gatshme për të bashkëpunuar në planin afatshkurter dhe afatgjatë.
- Tregu i punës ofron mundësi punësimi për shërbimin që ata ofrojnë.

Dokumentat që do të paraqesin bizneset aplikuese :

- Formë aplikimi
- Extrakt QKR
- Listëpagesat e tre muajve të fundit të punonjësve
- Fotokopje të Niptit
- Vërtetim llogarie bankare
- Referenca nga Institucione të Bashkisë Tiranë me të cilat kanë pasur bashkëpunim.
- Vërtetim nga Drejtoria e Tatimeve që subjekti nuk ka detyrime financiare për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore

4.4. Vlerësimi dhe përzgjedhja e biznesit

Takimi i Komisionit të Vlerësimit

Takimi i Komisionit të Vlerësimit të Biznesit do të organizohet nga Koordinatori, jo më vonë se 3 ditë pune pas përfundimit të aplikimit. Nëse është e nevojshme, këshilltarët e vlerësimit, trajnuesit ose përfaqësuesi i biznesit mund të ftohen në takim për shpjegime të mëtejshme se pse ky aktivitet kërkon të formojw profesionalisht të rinjtë.

Subjektet do të përzgjidhen duke pasur parasysh profilet e studimit që të rinjtë kanë aplikuar dhe ofrojnë siguri në punësimin e tyre në të ardhmen.

Procesi i përzgjedhjes do të kryhet nëpërmjet një sistemi pikëzimi, ku cdo aplikanti i jepet pikët nga 1 deri në 5 duke pasur parasysh : (5 shume i mire) (4 i mire) (3 mesatar) (2 i keq) (1 shume i keq)

Gjate sistemit te pikëzimit do te merret parasysh :

- Ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë së Tiranës.
- Ndërmarrjet që nuk kanë detyrime financiare ndaj pushtetit qendror dhe vendor.
- Zbatojnë Kodin e Punës në lidhjen e kontratave të punës me punëmarrësit.
- Janë të gatshme për të bashkëpunuar në planin afatshkurter dhe afatgjatë.
- Tregu i punës ofron mundësi punësimi për shërbimin që ata ofrojnë.

Të gjithë anëtarët e Komisionit duhet të bien dakord për rezultatet përfundimtare dhe listën e miratuar të bizneseve pjesëmarrëse.

Pas finalizimit të procesit të vlerësimit, Koordinatori do të përgatisë listën përfundimtare të bizneseve dhe do t'a depozitojë atë së bashku me *Procesverbalin e Takimit* në protokoll.

Shpallja e rezultateve të aplikuesve

Me përzgjedhjen dhe miratimin e kompanive, do të përzgjidhen aplikantët. Lista përfundimtare do të bëhet publike (në stendën e njoftimeve, faqen e internetit të Bashkisë dhe faqe të tjera të thëna më lart). Secili aplikant nëse e kërkon do të marrë një *Njoftim* me shkrim, të përgatitur nga Koordinatori i Projektit, sipas opinionit të ekspertëve nga vlerësimet përfundimtare me arsyen e mos përzgjedhjes në këtë praktikë.

Pas botimit zyrtar të rezultateve, kandidatët mund të depozitojnë një apelim me shkrim në Bashki brenda *pesë ditësh pune* nga marrja e njoftimit. Të gjitha apelimet e paraqitura brenda afatit përfundimtar rishqyrtohen nga Komisioni i Vlerësimit, që duhet të informojë aplikantin për vendimin dhe përfundimet e tyre me shkrim brenda *pesë ditësh pune*.

Për secilin aplikant të pranuar, do të jepet një *Certifikatë për kryerjen e Intershipit*. (Aneksi 7)

4.5. Kontraktimi dhe Përdorimi i Fondeve

Kontrata

Procesi për firmosjen e kontratës do të koordinohet nga Koordinatori dhe do të mbështetet nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike e Aseteve dhe Licensimit si dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar.

Kandidatët e përzgjedhur nënshkruajnë kontratën trepalëshe për një periudhë kohore jo më shumë se 6 muaj që nga dita e nënshkrimit, sipas përcaktimit të komisionit. Kontrata standard model në këto UO referuar në Aneksin 5 është e detyrueshme.

Aplikantët mund të dorëzojnë propozime për amendimin e kontratës, si dhe justifikime vetëm në rrethana të jashtëzakonshme të Koordinatorit të Projektit, i cili do të informojë më pas Komisionin Vlerësues dhe Drejtorinë Juridike për propozimet e paraqitura. Komisioni do të vendosë për miratimin ose refuzimin e propozimit pas përgjigjes që do të marrë nga Drejtoria Juridike. Ndryshimet mund të bëhen vetëm gjatë periudhës së zbatimit të kontratës dhe nuk do të kenë fuqi prapavepruese. Ndryshimet e miratuara do të integrohen në një aneks të firmosur nga palët.

Përdorimi i Grantit

Bashkia do të rimbursojë subjektin punëdhënës të përzgjedhur çdo muaj, sipas procedurës të parashikuar në kontratën në Aneksin 5.

Kontrasti i detyrimit kontraktual të aplikantëve të miratuar do të kryhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Sociale, nëpërmjet Drejtorisë të Nxitjes së Punësimit.

Drejtorja e Nxitjes së Punësimit, do të hartoi dhe verifikoi një Raport mujor mbi ecurinë e projektit, dhe bashkë me dokumentacionin suportues të përcaktuar në kontratën tre palëshe, do të bëjë kërkesën për financim pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Menaxhimit Financiar.

Kërkesa për financim, duhet të përmbajë minimalisht, Subjektet punëdhënës që do të rimbursohen, shuma që rimbursohet dhe periudhën e rimbursimit.

Në mbyllje të Programit, Drejtoria e Nxitjes së Punësimit do të hartojë dhe verifikojë Raportin Përfundimtar për Përdorimin e Kontributit.

Nëse aplikanti ndërpret kontratën e miratuar pa një arsye objektive (p.sh. shtrimi në spital për një kohë të caktuar, humbja e aftësive për punë si rrjedhojë e një aksidenti) do të ndërpritet menjëherë financimipër atë përfitues.

4.7. Monitorimi dhe Vlerësimi

Qëllimi i monitorimit të projektit është të sigurojë:

1. Informacion të saktë në kohë nëse Projekti është duke u zbatuar në përputhje me udhëzuesin, objektivat dhe kalendarin e tij;
2. Monitorimin e suksesit dhe efekteve të Projektit të zbatuar.

Drejtorja e Nxitjes së Punësimit do të monitorojë zbatimin në kohë të të gjitha fazave të projektit, sipas kalendarit të miratuar nga Bashkia. Informacioni i mbledhur gjatë këtij procesi monitorimi do t'i vendoset në dispozicion titullarit të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Sociale.

Përfaqësues të Bashkisë Tiranë, të përcaktuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë do të monitorojnë suksesin dhe efektet e zbatimit të Projektit duke vizituar aplikantët e pranuar në këtë Projekt dhe do të japin mendim nëse këto projekte i shërbejnë nxitjes së punësimit në Bashkinë e Tiranës.

Çdo kompani do të vizitohet çdo muaj për gjashtë muajt e përfshirjes në projekt nga mentorët. Vizitat në terren duhet të organizohen duke bërë përcaktimin paraprak të përfituesve, kjo miratuar nga titullari i drejtorisë. Punonjësit do të diskutojnë dhe marrin vendim për të gjitha vëzhgimet dhe çështjet e identifikuara gjatë vizitave në terren të cilat nëpërmjet procesverbalit do t'i vihen në dispozicion koordinatorit dhe titullarit të drejtorisë.

Mentorët do të shërbejnë si një burim informacioni kur përgatiten vizitat monitoruese.

Gjatë vizitave në terren, do të kontrollohen sa më poshtë, të cilat do të parashtrihen me detaje në *Formularin e Monitorimit*:

- Ecuria e punës
- Ndjekja e punës dhe zbatimi i orarit të përcaktuar nga punëdhënësi.
- Organizimi i Biznesit që e ka punësuar;
- Ndikimi i përdorimit të grantit, etj.

Një raport përfundimtar për projektin do të hartohet nga Koordinatorin në fund të çdo viti, duke përfshirë një analizë të projektit dhe rekomandime për ndryshimet.

Tregues të Performancës së Projektit

Treguesit e mëposhtëm statistikorë do të monitorohen gjithashtu gjatë zbatimit të projektit:

- Numri i dorëzuar i Formularëve të Aplikimit të Intershipit;
- Numri i aplikanteve të miratuar;
- Shuma e financimit të lëvruar;
- Numri i kontratave të firmosura të studentëve ;
- Sektorët ekonomikë në të cilat funksionojnë kompanitë;
- Numri i vendeve të hapura të punës gjatë procesit të realizimit të intershipit dhe në përfundim të tij ;

Këta tregues do të monitorohen gjatë çdo cikli Projekti, si dhe për të gjithë Projektin. Analiza krahasuese e rezultateve të arrira në çdo cikël pasues do të ofrojë informacion mbi dinamikën e Projektit dhe ecurinë e tij.

Rezultatet e vlerësimit do të masin suksesin e Projektit.

- Aneksi 1* – Njoftim Publik
- Aneksi 2* – Formular Aplikimi për Internship
- Aneksi 3* – Formulari i Vlerësimit për Aplikimin e Internshipit
- Aneksi 4* – Procesverbali për Vlerësimin e aplikanteve
- Aneksi 5* – Kontrata për Dhënien e Grantit (Akt-Marreveshja)
- Aneksi 6* – Formular Monitorimi
- Aneksi 7* – Certifikatë për Dhënien e Grantit

Njoftim Publik

PROJEKTI I BASHKISË SË TIRANËS “Të Rinjtë dhe të Rejat drejt një Profesionit”

1.1 Hyrje

Në..... (datë) Bashkia Tiranë do të fillojë zyrtarisht Projektin “Të Rinjtë dhe të Rejat drejt një Profesionit”, financuar nga burime publike dhe do të shpallin thirrjen e parë të hapur për dorëzimin e aplikimeve për të kryer një praktikë profesionale pranë Bizneseve nga të rinjtë e sapodiplomuar që janë të aftë për të qenë të suksesshem në një treg konkurrues në kërkim të një pune.

1.2 Rreth Projektit të Bashkisë së Tiranës për Fondin e Programit “Të Rinjtë dhe Të Rejat drejt një profesioni”.

Ky projekt synon sigurimin e punësimit për të rinjtë e sapodiplomuar, duke ndikuar drejtpërsëdrejti në uljen e papunësisë. Nëpërmjet këtij Programi mbështetet krijimi i vendeve të reja të punës, duke bashkëpunuar me punëdhënësin.

Krijimi i një mundësie intershipi do t’u shërbente të rinjve që nëpërmjet trajnimit, për një periudhë kohore jo më shumë se 6 muaj, sipas krediteve të kurrikulave trajnuese, për profesionet që ato kanë studiuar, të kryenin trajnimin pranë ndërmarrjeve publike apo private, të cilat do t’i aftësonin për t’u specializuar në profesionet më të kërkuara nga tregu i punës. Të rinjtë përfitues do t’u akordohet financimi mujor i pagës minimale bruto përmes punëdhënësve të tyre.

Bashkia do të rimbursojë subjektin punëdhënës të përzgjedhur çdo muaj, sipas procedurës të parashikuar në kontratën në Aneksin 5. Punëdhënësi do të depozitohet pranë Bashkisë Tiranë një kopje të listëpagesës të konfirmuar nga banka, si dhe kopje të listëpagesës depozituar në tatime dhe të FDP-së konfirmuar nga banka.

Punësueshmëria bazohet në aftësitë e vetë individit që i përgjigjet në kohë reale tregut të punës. Në kohë reale analizojmë cilat janë aftësitë bazë për çdo individ. Gjithashtu, aftësitë e profesionale janë po aq të rëndësishme, duke shtruar pyetjen “Sa i aftë është individit për t’iu përshtatur tregut të punës?” Këtu kryesisht fokusohemi tek rinjtë, duke i trajnuar dhe duke u vënë në dispozicion kryerjen e trajnimit në drejtim të zhvillimit të kompetencave për profesionin përkatës, duke i bërë ato me të afta për tregun aktual të punës me shpresën se në përfundim të intershipit do të jenë të afta të fitojnë experiencë mjaftueshëm për të siguruar një mundësi punësimi.

1.3 Mbështetja e Projektit

Qëllimi i Projektit është të japë një mbështetje për studentet e sapodiplomuar brenda apo jashtë vendit që nuk kanë pasur sukses në gjetjen e një pune dhe për të tejkaluar barrierat e ndryshme të tregut të punës. Për këto qëllime, Projektin është ndarë në 4 (kater) faza.

Faza e parë: Aplikimi nga kandidatët

Faza e dytë: Përzgjedhja e kandidatëve fitues

Faza e tretë: Fituesit e njoftuar do të firmosin një kontratë 3-6 mujore.

Faza e katërt: Monitorimi i procesit të intershipit

1.4 Aplikantët e Pranueshëm

Kandidatët dhe pjesëmarrësit e pranueshëm të Projektit janë të reja që jetojnë brenda apo jashtë vendit, rezidentë në territorin e Bashkisë së Tiranës, në kohën e aplikimit.

Të rinjtë që nuk përmbushin kriteret për t’u përzgjedhur janë ato të cilat kanë një konflikt interesi me palët e përfshira dhe vendimmarrësit e Projektit.

Çdo aplikant ka të drejtë për të marrë pjesë në Projekt dhe për të pasur akses në marrjen e Grantit që mund të përdoret vetëm një herë në vit.

Nuk pranohen aplikante qe kane kryer nje intership pranë të njëjtit subjekt apo kanë qenë më parë të punësuar pranë tij.

Të drejtën për të aplikuar e kanë:

- Të rinjtë dhe të rejtat që kanë përfunduar studimet brenda apo jashtë vendit, në një periudhë më pak se 36 muaj,
- Mosha deri 29 vjeç,

Do të trajtohen me prioritet të rejtat:

- Të rinjtë dhe të rejtat banore të Bashkisë së Tiranës, duke përfshirë edhe zonat rurale.
- Të rinjtë dhe të rejtat me aftësi të kufizuara;
- Të rinjtë dhe të rejtat që kanë përfunduar studimet me rezultate të larta;
- Të rinjtë dhe të rejtat të aftë për punë të familjeve që përfshihen në skemën e ndihmës ekonomike dhe grupeve të tjera te disavantazhuara.
- Të rinjtë dhe të rejtat të papunë që nuk u përkasin kategorive si më lartë, por do të punësohen në projekte të cilat janë në ndihmë të Bashkisë Tiranë.

1.5 Aktivitete Biznesi të Pranueshme

Aktivitetet e pranueshme për biznes janë nga sektorët e mëposhtëm, përkatësisht:

- Sistemi Bankar;
- Turizmi;
- Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimit (TIK);
- Industria;
- Shërbimet;
- Shërbime Ligjore, Konsulente, Financiare.

Sektorët mund të ndryshojnë gjatë vitit, në varësi të prioriteteve të parashtruara nga Bashkia.

Te drejtën për të aplikuar nga punëdhënësit e kanë :

- Ndërmarrjet që ushtrojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë së Tiranës.
- Ndermarrjet që nuk kanë detyrime financiare ndaj pushtetit qendror dhe vendor.
- Zbatojnë Kodin e Punës në lidhjen e kontratave të punës me punëmarrësit.
- Janë të gatshme për të bashkëpunuar në planin afatshkurter dhe afatgjatë.
- Tregu i punës ofron mundësi punësimi për shërbimin që ata ofrojnë.

Pavarësisht sektorit të përzgjedhur, *aktivitetet që nuk janë të pranueshme* për të marrë pjesë në trajnimin e të rejave në këtë Projekt janë :

- Aktivitet që janë per prodhimin e pijeve me përmbajtje të lartë alkooli dhe pijeve alkoolike të fuqishme;
- Prodhimin e produkteve të duhanit;
- Prodhimin dhe shpërndarjen e armëve;
- Prodhimin që përdor teknologjinë që shkakton ndotje mjedisore (si për shembull ndotje të ajrit, ujit, tokës, etj.);

1.6 Mbështetje financiare

Fondi total i projektit për vitin 2017-të është **2.100.000 LEKË**
ndaj të cilit do të shpallen **15- 20 përfitues** (në varësi të kërkesave që do të kenë subjektet)

1.7 Shpenzimet e Pranueshme

- Paga bruto.

1.8 Si të Aplikohet

Të gjithë Formularët e plotësuar të Aplikimit do të dorëzohen në Sektorin e Pritjes me Qytetarin në Bashki **në një kopje origjinale**. Aplikantët janë të detyruar që të dorëzojnë bashkëngjitur me *Formularin e Aplikimit* të gjitha llojet e dokumenteve që vërtetojnë arsimin, kualifikimin dhe eksperiencën e tyre. Po ashtu edhe dokumentet që vërtetojnë grupin prioritar.

Afati i fundit për dorëzim nuk është **më vonë se** (data dhe ora) në adresat në vijim:.....Formulari i plotësuar i aplikimit me dokumentet e bashkëngjitura duhet të dorëzohet personalisht ose me postë në sportelin e pritjes me brenda orarit të punës.

Çdo aplikim që merret pas datës së shpallur të mbylljes do të quhet i pavlefshëm.

Çdo aplikant mund të aplikojë vetëm në një subjekt.

1.9 Informacione të tjera

Informacione shtesë dhe Formulari i Aplikimit mund të gjenden në adresën www.....

Për më shumë informacion në Bashki, ju lutem kontaktoni (emri i personit nga Bashkia) në numrin e tel., ose në adresën në vijim:

Takimet informuese do të organizohen në (datë) nga (ora) në(vendi,adresa)

Aneksi 2 – Formulari i Aplikimit

Formular aplikimi për Internshipin

1. Informacione kontakti

Emri dhe Mbiemri	
Adresa	
Numri i telefonit	
E-maili	
Numri i Kartës së Identitetit	
Niveli dhe profili i arsimit	
Aftësi të tjera / mesatarja	
Profesioni	
Kategoria	

2. Cili është qëllimi juaj për pjesëmarrjen në programin e praktikave profesionale, mbështetur nga Bashkia e Tiranës dhe ku do të donit t`a zhvillonit këtë praktikë:

.....

.....
.....

3. Aftësitë, përvojat dhe njohuritë që zotëroj për të zhvilluar këtë praktikë profesionale*:

.....
.....
.....

4. Pse duhet të përzgjidheni ju për këtë praktikë profesionale:

.....
.....
.....

5. Ju i perkisni grupit(eve) të mëposhtme:

	<input type="checkbox"/> Të rinjtë nga zonat rurale të Bashkisë së Tiranës
<i>Të rinjtë dhe të rejat të sapodiplomuar</i>	<input type="checkbox"/> Të rinjtë me aftësi të kufizuar
	<input type="checkbox"/> Të rinjtë që i përkasin familjeve të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike ose grupeve të tjera të disaantazhuara.

***Ju lutemi na paraqisni edhe dokumente shitesë që vërtetojnë arsimin, aftësitë dhe eksperiencat e sipërpërmendura.**

Data e mbylljes së dorëzimit të dokumenteve të aplikimit është (data, ora). Lista e aplikantëve të aprovuar do të publikohet te Bashkia më (data). Informacioni do të jepet edhe nëpërmjet telefonit (numri).

Unë i/e nënshkruara deklaroj se të dhënat që përmban ky aplikim janë dhënë me vullnetin tim të lirë, në përputhje me mbrojtjen e të dhënave personale, të garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe në përputhje me Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", i cili garanton konfidencialitetin e të dhënave të klientit dhe në këtë mënyrë jap shprehimisht pëlqimin tim që ato të përdoren nga Bashkia e Tiranës për qëllime të kryerjes së aktivitete të saj.

Nënshkroi:

Data:

Aneksi 3 – Formulari i Vlerësimit për Aplikimin e Internshipit

Formulari i Vlerësimit për Aplikimin e Internshipit

Aplikanti:

Grupi I	Si të bëni matjen	Pikët përfundimtare
Dokumentet	Ka ofruar dokumentacionin që ka lidhje me arsimin, aftësitë dhe përvojat e punës. – 15 pikë, Që ka pjesërisht lidhje – 7 pikë, Mungojnë ose jo përkatëse – 0 pikë	
Pyetja 2	Ka lidhje - 15 pikë, Që ka pjesërisht lidhje - 7 pikë, Mungon - 0 pikë	
Pyetja 3	Ka lidhje– 15 pikë, Që ka pjesërisht lidhje - 7 pikë, E pa zhvilluar ose mungon - 0 pikë	
Pyetja 4	Ka lidhje– 15 pikë, Që ka pjesërisht lidhje - 7 pikë, E pa zhvilluar ose mungon - 0 pikë	
Prioritete	Grupe prioritare – deri në 15 pikë në varësi të numrit të grupeve prioritare qe kane me shume vështirësi në gjetjen e punës.	
Pikët jo përfundimtare (maks. 75)		
TOTALI		

Vlerësuesi:

Data:

Aneksi 4 – Procesverbali për Vlerësimin e Fituesve

Procesverbali për Vlerësimin e Punëdhënësit

Më..... (data) Komisioni i Vlerësimi u mbledh dhe shqyrtoi (numri) aplikime, të ardhura deri (ora) më (data),

Aplikimet e dorëzuara ;

Gjatë shqyrtimit të aplikantëve, Aplikantët e mëposhtme rezultuan të papranueshëm në kuadër të Projektit “Të Rinjtë dhe të Rejat drejt një Profesionit” nga Bashkia e Tiranës dhe si përfundim u vlerësuan si më poshtë :

Nr.	Emri i aplikantit	Pikët

Nëse disa prej aplikantëve të pranuar nuk konfirmojnë pjesëmarrjen e tyre në program, vendet e tyre do të zihen nga aplikantët pasardhës në renditje.

Falenderojmë të gjithë kompanite pjesëmarrëse në Projekt dhe i ftojmë ato që të aplikojnë sërish në vitet në vijim.

Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit:

1.

2.

3.

Aneksi 5 – Kontrata e bashkepunimit

BASHKIA TIRANE

KOMPANIA

AKT - MARRËVESHJE

Nr. Protokollit _____

Datë ____/____/____

Në zbatim të Vendimit të Këshillit të Keshillit Bashkiak, datë/...../2017, Nr. Prot...../...../..... Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të Projektit “Të Rinjtë dhe të rejat drejt një Profesionit” : Bashkia Tiranë përfaqësuar nga,

Subjekti _____, NIPT _____, përfaqësuar nga _____ (në vijim “Punëdhënësi”) dhe _____ (në vijim “Praktikanti”).

Kushtet paraprake:

- (a) Në kuadër të projektit “Të Rinjtë dhe të Rejat drejt një Profesionit”, Punëdhënësi ka paraqitur pranë Bashkisë Tiranë kërkesën për aplikim, i cili pasi është shqyrtuar për kushtet dhe kriteret e shpallura si dhe vlerësuar dobia e tij social- ekonomike, është miratuar me Vendim të Komisionit të Ndhmës Shtetërore, nr.....datë.....
- (b) Në lidhje me Projektin e Praktikës Profesionale, Punëdhënësi dhe Bashkia Tiranë nëpërmjet Komisionit të Vlerësimit ka përzgjedhur të rejat të cilat kanë aplikuar për këtë projekt në dt.....
- (c) Praktikanti i informuar rregullisht mbi Projektin e Praktikës Profesionale, është përzgjedhur për të marrë pjesë në praktikë dhe ka nënshkruar Deklaratën e Pjesëmarrjes në Projekt;
- (d) Bashkia Tiranë, Punëdhënësi dhe Të Rinjtë së bashku lidhin këtë Marrëveshje për zbatimin e Projektit të Praktikës Profesionale sipas dispozitave të mëposhtme :

Neni 1 – Objekti i Kontratës

Me anë të kësaj Kontrate, Bashkia Tiranë dhe Punëdhënësi përcaktojnë të drejtat dhe detyrimet e tyre si palë bashkëpunuese në zbatimin e Projektit të Praktikës Profesionale, si dhe përcaktohen të drejtat dhe detyrat e Praktikantëve gjatë kohës së kësaj praktike. Në bazë të këtij Projekti, Praktikantët që do të zhvillojnë praktikën profesionale pranë Punëdhënësit duke përfituar mbështetje financiare nga Bashkia Tiranë në formën e rimbursimit të shpenzimeve për pagat bruto të aplikantit të përzgjedhur sipas afatit kohor përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate.

Neni 2 - Kohëzgjatja e Kontratës

- 2.1 Kjo Kontratë hyn në fuqi në datën ...nga Palët.
- 2.2 Kohëzgjatja e praktikës profesionale për Praktikantët do të jetë ____ (__ me shkronja__) Jo me shume se 6 muaj.
- 2.3 Efektet financiare të kësaj Kontrate fillojnë dhe përfundojnë brenda vitit 2017.
- 2.4 Kontrata do të jetë e vlefshme dhe e efektshme midis Palëve deri në datën e mbarimit të Projektit të Praktikës Profesionale, por në çdo rast jo më gjatë se data 31 dhjetor i të njëjtit vit të lidhjes së Kontratës, afati maksimal i së cilës korrespondon me mbylljen e vitit buxhetor. Palët bien dakort se kjo Kontratë mund të shtrijë efektet e saj edhe në vazhdim të vitit pasardhës buxhetor në diskrecionin e DNP-së sipas fondeve të alokuara nga buxheti i Bashkisë Tiranë për Drejtorinë e nxitjes së punësimit. Për këtë qëllim, Palët do të nënshkruajnë një shtojcë të kësaj Kontrate ku do të përcaktohet zgjatja e afatit të Kontratës për periudhën e vendosur rishitazi.

Neni 3 – Mbështetja financiare dhe pagesat

- 3.1 Punëdhënësi do të paguajë çdo muaj punëmarrësin për pagën neto, sipas ditëve të punës përkatëse.
- 3.2 Punëdhënësi është përgjegjës që të paguajë në kohë kontributet e punëmarrësit dhe punëdhënësit pranë degës rajonale të Tatimeve.
Punëdhënësi depoziton pranë Bashkisë Tiranë, kopje të listëpagesës, E-sig 25 dhe mandateve bankare që vërtetojnë shlyerjen e detyrimeve ndaj punëmarrësit dhe shlyerjen e detyrimeve tatimore për këtë punëmarrës.
- 3.3 Bashkia Tiranë merr përsipër që jo më vonë se 30 ditë kalendarike nga depozitimi i dokumentacionit të bëjë rimbursimin e shpenzimeve mujore në favor të punëdhënësit.

Neni 4 – Koha e praktikës

4.1 Koha javore normale e praktikës është __(__me shkronja__) orë, ndërsa koha ditore është __(__) orë.

4.2 Praktikanti ka të drejtën e 2 (dy) ditëve pushim në javë, si dhe pushimin në ditët e festave zyrtare.

Neni 5 – Detyrimet e Punëdhënësit

5.1 Gjatë periudhës së praktikës profesionale, Punëdhënësi duhet të sigurojë me koston e vet, në çdo kohë, Kujdestar të përshtatshëm për një apo disa Praktikantë, kushtet e punës, ndërtesën, ambjentet dhe bazën materiale të nevojshme për mbarëvajtjen e rregullt të praktikës sipas Projektit të Praktikës Profesionale të miratuar. Punëdhënësi duhet të njoftojë menjëherë Bashkinë Tiranë për çdo Praktikant që largohet përpara afatit kontraktor për të bërë zëvendësimin/et përkatëse në Listën e Aplikantëve të cilët janë renditur me pikë më pak gjatë fazës së aplikimeve.

Gjatë kohëzgjatjes së Projektit të Praktikës Profesionale, Punëdhënësi ka detyrimin të bashkëpunojë me Bashkinë Tiranë dhe t'i sigurojë të gjithë informacionin dhe raportimet e kërkuara për monitorimin dhe ecurinë e tij.

Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Kontrate, Punëdhënësi duhet të dorëzojë cdo muaji pranë Bashkisë Tiranë Listëprezencën e Praktikantëve në Projektin e Praktikës Profesionale, pas kryerjes së pagesës, Punëdhënësi duhet të dorëzojë pranë Bashkisë së Tiranës listëpagesën e përfituesve, kopje të E-sig 25 dhe të mandateve bankare që vërtetojnë kryerjen e këtyre pagesave.

Neni 6 – Detyrimet e Praktikantit

6.1 Praktikanti kryen detyrat e tij personalisht ashtu sic i ngarkohen nga Punëdhënësi, referuar Kodit të Punës.

6.2 Praktikanti i kryen detyrat e tij duke ndjekur udhëzimet e përgjithshme dhe specifike të Punëdhënësit dhe/ose kujdestarit sipas rastit.

6.3 Praktikanti do të respektojë rregulloren/t e brendshme të Punëdhënësit dhe çdo rregullore të veçantë lidhur me detyrën e ushtruar sipas kësaj Kontrate njësoj si punonjësit e tjerë të Kompanisë.

6.4 Praktikanti do të përdor pajisjet dhe mjetet e siguruar nga Punëdhënësi vetëm për qëllimet që lidhen me përmbushjen e detyrave të tij dhe në asnjë rast Praktikanti nuk mund t'i përdorë ato për qëllime personale. Me përfundimin e kësaj Kontrate, Praktikanti do t'ja kthejë menjëherë këto pajisje dhe mjete Punëdhënësit.

6.5 Praktikanti merr përsipër të mbajë të fshehtë çdo çështje që lidhet me Punëdhënësin apo biznesin e tij, gjatë punësimit dhe pas përfundimit të kësaj Kontrate për çfarëdolloj arsye. Praktikanti nuk mund të përdorë për qëllime private asnjë informacion apo dokument, pronë e Punëdhënësit apo që lidhet drejtpërdrejtë apo indirekt me biznesin e Punëdhënësit dhe as ti bëjë ato publike për palët e treta

Neni 7 – Detyrime dhe angazhime të Bashkisë Tiranë

7.1 Bashkia Tiranë duhet të sigurojë mbështetjen financiare dhe rimbursimin e shpenzimeve të pranuar për secilin nga Praktikantët sipas nenit 3 të kësaj Kontrate brenda afateve dhe mënyrave të përcaktuara për këtë qëllim në këtë Kontratë dhe legjislacionin në fuqi, pasi të verifikohen pagesat nga ana e punëdhënësit në llogari dhe për llogari të punëmarrësit.

7.2 Bashkia Tiranë mund të monitorojë Projektin e Praktikës Profesionale dhe të kërkojë informacion të azhurnuar nga Punëdhënësi në lidhje me zbatimin e tij. Për çdo vizitë monitoruese do të mbahet procesverbal i cili i bashkangjitet dosjes së Projektit të Praktikës Profesionale.

Neni 8 - Zgjidhja e Kontratës

8.1 Bashkia Tiranë ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë me efekt të menjëhershëm në lidhje me secilin Praktikant në rast se Punëdhënësi gjatë kohëzgjatjes së Projektit të Praktikës Profesionale, shkel në ndonjë mënyrë, ose largon pa shkaqe të arsyeshme Praktikantin që kryen praktikën profesionale sipas kësaj Kontrate.

8.2 Bashkia Tiranë ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë nëse Punëdhënësi shkel një ose disa prej detyrimeve të tjera të parashikuara në këtë Kontratë, përfshirë Projektin e Praktikës Profesionale, dhe nuk i përmbush ato brenda një afati 7 (shtatë) ditor nga marrja e njoftimit të Bashkisë Tiranë për të përmbushur detyrimet e shkelura.

8.3 Punëdhënësi ka të drejtë të zgjidhë këtë Kontratë në mënyrë të njëanshme në rast se Praktikanti:

(a) është i paafte nga ana fizike apo intelektuale për kryerjen e detyrës së tij sipas kësaj Kontrate ose nëse vërtetohet se shëndeti apo morali i tij kompromentohen apo mund të kompromentohen gjatë apo nga ushtrimi i kësaj detyre;

(b) Kryen një shkelje të rëndë ose një shkelje të lehtë të përsëritur të rregullores/ve të brendshme të Punëdhënësit dhe disiplinës në punë, megjithë paralajmërimet e Punëdhënësit;

(c) I provohet fajësia për një krim në ngarkim të tij me vendim të formës së prerë të një gjykate ose dënohet me vendim të formës së prerë të gjykatës për ndalimin e ushtrimit të një veprimtarie apo mjeshtrie të caktuar që lidhet me detyrat sipas kësaj Kontrate;

(d) Bën ofendime të përsëritura, ushtron presion apo kërcënon, krijon konflikte me koleget;

(e) Shkel ndonjë nga detyrimet e tij të tjera sipas kësaj Kontrate.

8.4 Në rast se Praktikanti vendos të zgjidh këtë Kontratë, ai duhet të njoftojë me shkrim Punëdhënësin të paktën 1 (një) muaj përpara zgjidhjes së Kontratës si edhe Bashkinë Tiranë

8.5 Pavarësisht nga dispozitat e Nenit 8.3 dhe 8.4, Punëdhënësi apo secili Praktikant mund të zgjidh këtë Kontratë në rast mospërmbushjeje të çdo lloji për të cilën pala tjetër konsiderohet përgjegjëse sipas kësaj Kontrate dhe legjislacionit të zbatueshëm.

8.6 Për të shmangur çdo dyshim, asgjë këtu nuk paragjykon të drejtën e Palëve për të kërkuar, përveç zgjidhjes së Kontratës, edhe shpërblimin e dëmit sipas rastit.

Neni 9 - Ligji i zbatueshëm

Kjo Kontratë përfshin të drejtat dhe detyrimet e Palëve, ku mbështeten dhe rregullohen nga legjislacioni shqiptar. Për çdo mosmarrëveshje që lind ndërmjet Palëve në lidhje me zbatimin e kësaj Kontrate dhe që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet tyre do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjqësor Tirane

Neni 10 - Të Ndryshme

10.1 Asnjë ndryshim apo përjashtim nga dispozitat e kësaj Kontrate nuk do të ketë vlerë ligjore përveç rastit kur ai bëhet me miratimin me shkrim të Palëve.

10.2 Praktikanti ose Punëdhënësi nuk ka të drejtë të kalojë, tërësisht apo pjesërisht, të drejtat dhe detyrimet e tij sipas kësaj Kontrate.

Kjo Kontratë është hartuar në 5 (pesë) kopje origjinale në gjuhën shqip.

1 Kopje qendron ne Protokollin e Bashkisë Tiranë.

1 Kopje qendron ne DPMF Tiranë.

1 Kopje depozitohet pranë Punëdhënësit
 1 Kopje Punëmarrësi
 1 Kopje qendron pranë DNP-së
 10.3

Për PRAKTIKANTIN

Për PUNËDHËNËSIN

Për BASHKINË TIRANË

Aneksi 6 – Formulari i Monitorimit

FORMULARI I MONITORIMIT

Subjekti.....Punëmarrësi.....

Pyetjet e monitorimit për subjektet që janë përfshirë në Program			
A po zhvillohen aktivitetet sipas programit? Ju lutem përshkruani ndonjë ndryshim të paautorizuar që u bë gjatë vizitës për monitorimin:	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Pjesërisht
A janë mjediset e biznesit në kushtet e përshtatshme? Ju lutem përshkruani gjendjen e mjediseve, lejet përkatëse, etj.:	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Pjesërisht
A i ka biznesi të gjitha lejet, licencat, patentat, certifikatat, politikat e sigurimeve përkatëse dhe dokumente të tjera në lidhje me performancën e aktiviteteve të biznesit, siç specifikohen në kontratë.	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Pjesërisht
A është paraqitur rregullisht praktikanti në ambientin e punës sipas kushteve të kontratës ?	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Pjesërisht
A po aktivizohet praktikanti mjaftueshëm për të zbatuar detyrat e ngarkuara ?	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Pjesërisht
Te tjera	<input type="checkbox"/> Po	<input type="checkbox"/> Jo	<input type="checkbox"/> Pjesërisht

PËRFUNDIMI: *Deri më sot, praktikanti po arrin mjaftueshëm / jo mjaftueshëm detyrat e ngarkuara. (shpreh opinionin mentor)*

REKOMANDIME:

Data:

Vizita në terren zgjati deri orë.

Përfaqësuesi i Kompanisë:
/nënshkrimi/

Specialisti i Monitorimit:
/nënshkrimi/





Projekti i Bashkisë së Tiranës “Të Rinjtë dhe të Rejat Drejt një Profesionit”

CERTIFIKATË

Nr .. /2016

Për zbatimin me përgjegjshmëri të Internshipit të miratuar nga Bashkia e Tiranës, i jepet kjo Çertifikatë në shenjë falenderimi.

i jepet Z/ Znj.

Punëdhënësi

.....

Kryetar i Bashkisë

.....

